



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-1456/1 të 06.04.2021, HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent, dhe denoncimi duhet të dorëzohet për veprim kompetent në Këshillin e Prokurorëve Publik.

Lënda me numër 12-1456/1 të datës 06.04.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Më 06.04.2021 një kërkesë u dorëzua nga një parashtrues i panjohur dhe është formuar lënda me numër 12-1456/1 të datës 06.04.2021

Denoncimi dorëzohet kundër----- zëvendës prokuror publikë në PTHP -----dhe -----nga-----deputet nga radhët LSDM-së. Për sa i përket këtyre personave, thuhet se në një objekt të caktuar hotelerie ata kanë mbajtur një takim me personin -----, dhe sipas njohurive të paraqitur temë e bisedës në takim ishte veprimi në një çështje penale që është drejtuar kundër tij. Ky person ishte i njohur për publikun për ndërtimin e një hoteli në një lagje, ndërtimi i të cilit u ndërpre disa herë dhe banorët e lagjes e konsideronin atë një divagogë. Në vijim thuhet se në takim prokurori publik e ka këshilluar personin fizik që të punësojë një person të caktuar të aftë i cili di të nxjerrë konstatimin e aftë që personi fizik do ta përdorte si provë në favor të tij në procedurë penale.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në kërkesë janë paraqitur supozime për bisedime të kryera, dhe duke pasur parasysh se parashtruesi është i panjohur, KSHPK-ja nuk është në gjendje të sigurojë prova për të njëjtat dhe të vlerësojë se nuk ka elemente për një veprim kompetent, dhe kërkesën për të dorëzuar një veprim kompetent në Këshillin e Prokurorëve.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: B.K.SH

КОМИСИОН ШТЕТЁРОРЕ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Nёnkryetar  
Nuri Bajrami

